


REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA - OPSTINA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT

Nr. i Prot. 03/6575
Nr. i Faq. 2 Data 18.08.2022

RAPORTI GJASHTËMUJOR 2022

- DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME -



Drejtoria e Administratës së Përgjithshme gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2022 ka qenë e përkushtuar për miratimin dhe funksionimin e rregullt të sistemit Intranet ku procesohen kërkesat/ankesat dhe shërbime të tjera me qytetarët.

Kemi pasur efikasitet në shërbimet e gjendjes civile me kërkesat e qytetarëve.

Vendosja e pajisjes për sistemin e vijushmërisë në punë në bashkëpunim me ASHI-në në kuadër të ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Zgjerimi i rrjetit brenda komunës për lehtësim të qasjes së zyrtarëve komunal në rrjet të ofruar nga Komuna.

Janë zgjedhur bashkësitë lokale në Komunën e Hanit të Elezit në të gjitha lokalitetet sipas rregullore për organizimin e këshillave të fshatrave.

Ka filluar transmetimi i seancave live në kuvendin komunal të Hanit të Elezit dhe gjithashtu po përmbushim kriter të transparencës komunale.

Funksionalizimi i fibrës optike (back-up) përmes MAPL-së.

Pjesëmarrje nëpër trajnime, seminare, konferenca të cilat prekin drejtëpërdrejtë interesin e Administratës së Përgjithshme për sjelljen e aktivitetetve të reja.

Në sektore të administratës janë kryer këto aktivitete:

QENDRA PËR SHËRBIM ME QYTETARË:

- Janë regjistruar 4851 lëndë nëpër drejtori përkatëse.

GJENDJA CIVILE:

- Janë lëshuar 3182 certifikata të llojeve të ndryshme në bazë të kërkesave përkatëse të qytetarëve.

DEPO:

- Janë regjistruar 102 kërkesa për furnizim nga depoja komunale dhe janë regjistruar 16 kërkesa për furnizimin e depos.

AUTOPARKU:

- Janë regjistruar 294 kërkesa, ndërsa janë llogaritur 52626 km të kaluara dhe furnizim me karburante janë 4216 litra.

SEKTORI I KUVENDIT:

- Kuvendi Komunal ka mbajtur 6 mbledhje të rregullta, 2 mbledhje solemne.
- Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 6 mbledhje të rregullta.
- Komiteti për Komitetet ka mbajtur 6-të mbledhje.
- Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuar ka mbajtur 3 mbledhje.
- Janë hartuar 15 procesverbale për Kuvendin Komunal të Komunës së Hanit të Elezit.
- Janë bërë 26 vendime të ndryshme.

ARKIVA:

- Numri i lëndëve të arkivuara janë 847 lëndë.



Drejtoreshë e Administratës së Përgjithshme,
Injsh. Natyra Kalisi